



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

27 Janar 2024

Version publik

PROPOZIME PËR SHTESA DHE NDRYSHIME
NË KODIN PENAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

“PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA
KRIMET SEKSUALE”

Tiranë, Janar 2024

PROPOZIME LIGJORE PËR KODIN PENAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Neni 100, titulli i nenit dhe përmbajtja e tij të ndryshohen si më poshtë:

Neni 100

Marrëdhënia seksuale me fëmijë nën moshën e marrëdhënies seksuale

Kryerja e veprimeve apo marrëdhënies seksuale me fëmijën, që nuk ka mbushur moshën **gjashtëmbëdhjetë vjeç**, me çdo mjet ose formë, **nga i rrituri**, dënohet me burgim **nga dhjetë** gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur veprimet ose marrëdhënia seksuale kryhet **me dhunë**, me çdo mjet ose formë, nga personi **që nuk ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale** dënohet me burgim jo më pak se katër vjet.

Kur veprimet ose marrëdhënia seksuale kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, **me më shumë se një fëmijë**, ose kur i janë shkaktuar fëmijës së dëmtuar pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet.

Kur vepra ka sjellë si pasojë **zhdukjen, vetëvrasjen** ose **vdekjen** e fëmijës dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Të shtohet neni 100/a me përmbajtje si më poshtë:

Neni 100/a

Shtytja e fëmijës për të kryer veprime me natyrë seksuale për një të rritur (grooming)

Nxitja, joshja, shtytja, mashtrimi ose manipulimi i fëmijës nën gjashtëmbëdhjetë vjeç, nga i rrituri, me çdo mjet ose formë, për të kryer veprime ose marrëdhënie seksuale, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim **nga shtatë deri në dhjetë vjet**.

Kur këto veprime kryhen nga **personi që ka mbushur moshën e përgjegjësisë penale**, me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim **jo me pak se tre vjet**.

Kur këto veprime kryhen në bashkëpunim, nga persona që kanë mbushur moshën e përgjegjësisë penale, më shumë se një herë, **me një fëmijë më shumë fëmijë**, ose kur i janë shkaktuar fëmijës së dëmtuar pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se **dhjetë vjet**.

Kur vepra ka sjellë si pasojë vetëvrasjen e fëmijës dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

Të shtohet neni 100/b me përmbajtje si më poshtë:

Neni 100/b

Komunikimi me fëmijën me mesazhe për qëllime seksuale (Sexting)

Komunikimi me fëmijën nën gjashtëmbëdhjetë vjeç, me mesazhe, foto apo video, me çdo mjet ose formë, që kanë qëllime ose natyrë seksuale, nga personi që ka mbushur moshën e përgjegjësive penale, përbën kundravajtje penale dhe dënohet me burgim deri në 3 vjet.

Neni 101, emërtimi dhe përmbajtja të ndryshohen si më poshtë:

Neni 101

Marrëdhënia seksuale me dhunë fëmijë mbi 16 dhe nën 18 vjeç

Kryerja e veprimeve apo marrëdhënies seksuale me të miturin mbi gjashtëmbëdhjetë dhe nën tetëmbëdhjetë vjeç, me çdo mjet ose formë, nga i rrituri, dënohet me burgim nga 3 deri në pesë vjet.

Kryerja e veprimeve ose marrëdhënieve seksuale me dhunë, me çdo mjet ose formë, **me të miturin e moshës mbi gjashtëmbëdhjetë dhe nën tetëmbëdhjetë vjeç**, nga personi që ka mbushur moshën e përgjegjësive penale, dënohet me burgim nga **shtatë** gjer në pesëmbëdhjetë vjet.

Kur veprimet apo marrëdhënia kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, **me më shumë se një fëmijë ose** person që nuk ka mbushur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, ose kur personit të dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim nga **pesëmbëdhjetë** gjer në njëzet vjet.

Neni 117, të ndryshojë si më poshtë:

Neni 117 (Pornografia e fëmijëve)

Mbrojtja e femijëve dhe e të miturve nga dhuna dhe shfrytëzimi seksual nga rregjistrimet me figurë, imazh dhe me zë

Mbajtja, prodhimi, shfaqja, lejimi, ofrimi, shpërndarja, transmetimi, reklamimi, importimi, shitja apo botimi i materialeve pornografike në mjedise ku ka fëmijë nën moshën 18 vjeç, me çdo mjet ose formë, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim deri **në shtatë vjet**.

Mbajtja, prodhimi, riprodhimi, regjistrimi, importimi, shitja, ofrimi, shpërndarja, transmetimi, shfaqja, shkëmbimi ose përdorimi i materialeve me përmbajtje të dhunës apo marrëdhënies seksuale me fëmijë ose ndërmjet femijeve **nën moshën 18 vjeç**, me çdo mjet ose formë, nga personi që ka mbushur moshën e përgjegjësive penale, dënohet me burgim **nga dhjetë gjer në pesëmbëdhjetë vjet**.

Rekrutimi, shtrëngimi, nxitja, joshja, manipulimi, kërcënimi, detyrimi, dhunimi ose përdorimi i fëmijës nën moshën 18 vjeç, për të marrë pjesë në veprime ose shfaqje me natyrë seksuale, me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Përdorimi i imazhit të femijës, të vertetë ose të gjeneruar nga teknologjia, ku fëmija angazhohet në veprime ose marrëdhënie seksuale, për prodhim, riprodhim, shpërndarje, reklamim, transmetim,

shkëmbim, shfaqje, mbajtje, përdorim personal, shitje ose botim, me çdo mjet ose formë, përbën vepër penale dhe dënohen me me burgim nga tre deri në pesë vjet.

Përrjashtohen nga përgjegjësia penale vetëm personat dhe subjektet që, në bazë të ligjit dhe me autorizim nga Policia e Shtetit, punojnë apo angazhohen në mbrojtje të fëmijës nga dhuna seksuale. (PËR TU DISKUTUAR!)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

27 Janar 2024

RELACIONI SHOQËRUES

PËR

PROPOZIME PËR SHTESA DHE NDRYSHIME
NË KODIN PENAL TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

“PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE NGA KRIMET SEKSUALE”

Tiranë, Janar 2024

RELACIONI SHOQËRUES

për ndryshime dhe shtesa në Kodin Penal

QËLLIMI I PROJEKT-LIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË KËRKOHEN TË ARRIHEN

Propozimet ligjore të mëposhtme, kanë si qëllim të sjellin ndryshime në disa aspekte specifike të një serë veprash penale të kryera ndaj fëmijëve, por edhe ndaj të rriturve, gjatë lundrimit të tyre në internet dhe për mbrojtjen nga dhuna seksuale. Natyra e këtyre krimeve është e tillë që kërkon të krijojë mbrojtje të posaçme për fëmijët, në mënyrë që ta bëjë lundrimin e tyre në internet sa më të sigurt dhe nga ana tjetër, të parandalojë këto vepra penale, duke kriminalizuar sjelljen dhe veprimet e të rriturve, kur ata duan që ta përdorin internetin si mjet për të abuzuar apo shfrytëzuar seksualisht fëmijët dhe të miturit, nën moshën 18 vjeç.

Dhuna seksuale ndaj fëmijëve dhe grave është kthyer sot në një ndër shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut. Studimet tregojnë se rreth 11% e fëmijëve deklarojnë se janë viktimat të dhunës dhe ngacmimeve seksuale nga të rriturit dhe bashkë-moshatarët e tyre. Strudimet në Shqipëri, por edhe në nivel global, tregojnë se grabitqarët seksualë po përdorin internetin për gjetur viktimat e krimeve të tyre seksuale.

Së dyti, projekt-ligji kërkon të trajtojë ligjërisht duke zgjidhur një herë e mirë, aspektet e marrëdhënies seksuale të fëmijëve nën moshën 18 vjeç me të rriturit, duke e sjellë Kodin Penal në përputhje me Kushtetutën, e cila në nenin 56 të saj sanksionon mbrojtjen e posaçme për fëmijët. Kjo nënkupton se një person i rritur nuk duhet të ketë një marrëdhënie seksuale me një fëmijë nën moshën 18 vjeç. Po në këtë aspekt, kjo mbyll edhe hapësirën ligjore, ku Kodi i Familjes lejon martesën e personit kur ka mbushur 18 vjeç, ndërkohë që Kodi Penal, i garantonte të drejtën një të rrituri të kishte marrëdhënie me fëmijë nën moshë, gjë që nga praktika është parë që kjo marrëdhënie është kthyer në situata shtrëguese, abuzuese apo shfrytëzuese për fëmijët nën moshën 18 vjeç, sidomos vajzat.

Po ashtu, projekt-ligji kërkon të eliminojë gjuhën diskriminuese. Për këtë qëllim, ne kemi sjellë shembuj konkretë nga disa Kode Penale të vendeve të BE-së në lidhje me termat dhe përkufizimet që ata përdorin për këtë qëllim.

Projekt-ligji kërkon që të ofrojë një mbrojtje më të mirë për të gjithë viktimat e dhunës seksuale, vajza dhe djem nën 18 vjeç, për t'iu ofruar atyre të gjithë mbrojtjen dhe mbështetjen ligjore që shteti zotëron për të ndjekur penalisht dhe për të dënuar këto vepra penale, por duke përforcuar njëkohësisht edhe elementin parandalues të kryerjes së veprës penale.

Po në këtë kuadër një risi e projekt-ligjit është propozimi për të rritur moshën e dhënies së pëlqimit për marrëdhënien seksuale nga 14 vjeç që është aktualisht në 16 vjeç. Ndërkohë që sanksionohet qartazi që të rriturit nuk mund të angazhohen në marrëdhënie me pëlqim me një person mbi 16 vjeç dhe nën moshën 18 vjeç, por kjo fashë moshore vlen vetëm për të krijuar një mbrojtje ligjore për adoleshentët kur ata angazhohen me marrëdhënie seksuale me pëlqim ndërmjet njëri-tjetrit. Të gjitha këto shtesa e ndryshime e përafrojnë legjislacionin tonë me

shumicën e vendeve të BE-së, të cilat sanksionojnë moshën 16 vje me pëlqim si moshë bazë të dhënies së pëlqimit gjithmonë ndërmjet personave në të njëjën moshë, duke ndaluar dhe penalizuar të rriturit që duan të angazhohen në veprime apo marrëdhënie seksuale me persona nën 18 vjeç.

ARGUMENTIMI I PROJEKT-LIGJIT LIDHUR ME PERPARËSITË, PROBLEMATIKAT DHE EFEKTET E PRITSHME

Për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur në legjislacionin shqiptar për fëmijët, legjislacionit penal i ka dalë për detyrë që të përfshijë disa vepra apo cilësi të reja në dënimin e autorëve të tyre. Ndryshimet në Kodin Penal të vitit 2001, 2008, 2010 dhe 2013, 2017, ndonëse sollën një serë ndryshimesh pozitive, nuk arritën të plotësonin kuadrin rregullator penal dhe një pjesë e veprave penale ndaj të fëmijëve dhe të miturve. Nga ana tjetër, veprat penale në fushën kibernetike, hyjnë në atë grup veprash penale kundër moralit dhe dinjitetit të personit.

Ngjarjet e ditëve të fundit ku vajzat, duke filluar nga moshë 10 vjeç ishin kthyer në objekte të bashkëjetesave apo martesave të shtirura, që në fakt nuk ishin asgjë tjetër veçse marrëdhënie të dhunshme dhe shfrytëzuesesë të fëmijëve nga të rriturit, janë të papranueshme në një shoqëri të civilizuar dhe në një shtet demokratik.

Kushtetuta e Shqipërisë i garanton mbrojtje të posaçme fëmijës, ndaj është detyrë e këtij Kodi që t'a shtrijë parimin e mbrojtjes së posaçme tek të gjithë fëmijët. Konventa për të Drejtat e Fëmijës së OKB-së, Konventa e Lanzarotit e Këshillit të Europës, kërkojnë ndër të tjera që fëmijët nën moshën 18 vjeç të jenë të mbrojtur nga çdo formë, veprim dhe marrëdhënie seksuale me të rritur, pasi të rriturit kanë për detyrë të mbrojnë e kujdesen për fëmijët e jo t'i shfrytëzojnë ata për qëllime seksuale.

Policia e Shtetit raporton se thuhet se çdo vit janë të paktën 120-150 krime seksuale që kryen ndaj fëmijëve nën moshën 18 vjeç në Shqipëri, të cilat përbëjnë rreth 80% të të gjitha krimeve seksuale të kryera në vend.

KRIMET SEKSUALE NE SHOIPERI SIPAS RAPORTIMEVE NË POLICI (2008-2022)															
Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Nr.	75	78	71	40	40	77	99	130	110	100	105	148	132	129	143

Siç shihet edhe nga tabela, vihet re një dyfishim i krimeve seksuale ndaj fëmijëve nën 18 vjeç nga viti 2008 në vitin 2022. Viktimat më të prekura të këtyre grupimeve i përkasin moshës 13-14 vjeç që është thuhet se kufiri aktual i marrëdhënies së lejuar dhe me pëlqim të hyrjes në një marrëdhënie seksuale. Ndaj në këtë kuadër, rritja e moshës nga 14 në 16 vjeç, jo vetëm vendos një tavan mbrojtës për fëmijët nën këtë moshë për të mos-hyrë në marrëdhënie seksuale të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike dhe emocionale me një të rritur, por edhe e sjell moshën e dhënies së pëlqimit të hyrjes në marrëdhënie seksuale në një stad ku adoleshentët janë shumë herë më të aftësuar për ta kuptuar marrëdhënien seksuale dhe pasojat e saj, gjithnjë brenda përbrënda grup-moshës së tyre. Po duke ruajtur këto parime kjo rritje e moshës për dhënien e pëlqimit e vendos Shqipërinë në grupin e shumë shteteve të BE-së ku moshë është 16 vjeç.

Nga ana tjetër vihet re një rritje e dhunës dhe ngacmimeve seksuale në hapësirën kibernetike ose ndryshe online ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve. Në këtë kuadër, si rritja e moshës ashtu edhe

vendosja e ndalimit për personat e rritur, të mos angazhohen në veprime dhe marrëdhënie seksuale me fëmijë nën moshën 18 vjeç shtrihet edhe në hapësirën kibernetike, ndërkohë që në Kodin aktual kjo nuk ishte e parashikuar.

Linja Kombëtare për Sigurinë e Fëmijëve në Internet (iSIGURT.al) raportoi ndërmjet viteve 2019-2022 një rritje me gjashtëfish të numrit të incidenteve të raportuara nga fëmijët të dhunës e ngacmimit seksual të tyre nga persona të rritur, të cilët sot janë të pambrojtur nga ligji penal kur këto ngjarje ndodhin online. Ndaj ne kemi propozuar të shtohen edhe 2 nene të reja, njëra që ka të bëjë me rregullimin e joshjes, nxitjes dhe manipulimit të fëmijës për të hyrë në marrëdhënie seksuale, që shpesh fillon online dhe më pas kthehet në një makth real e të përditshëm për fëmijën, ndërsa tjetra ka të bëjë me ngacmimet që të rriturit i bëjnë fëmijëve duke ju nisur atyre mesazhe me natyrë apo për qëllime seksuale në chat-e apo në celular, ose në platforma sociale etj.

Për vitin 2022 iSIGIURT.al raportoi mbi 150 incidente të fëmijëve të ndodhura online, si më poshtë:

Problematika	Numri i incidenteve
Ekspozim ndaj imazheve apo materialeve me përmbajtje seksuale	51
Cyber bullying	74
Bulizëm nëpërmjet celularit	13
Pornografi me fëmijët në internet	4
SMS dhe pastime ofenduese	8

Së fundi, siç e kemi theksuar edhe më sipër, ne propozojmë heqjen e termit “homoseksuale” në nenet e ndryshuara dhe të paraqitura në këtë projek-ligj për shkak sepse dhuna seksuale ndaj fëmijëve prodhon pasoja të njëjta si për djemtë dhe për vajzat. Ajo është dhunë dhe mbetet dhunë. Shqipëria është i vetmi vend në Europë që vijon ta përdorë këtë term në legjislacionin e tij penal, që është në fakt një atavizëm i mbetur nga peroudha e errët e komunizmit. Si shembull po sjellim emërtimet përkatëse të disa legjislacioneve të vendeve të BE-së.

KODE PENALE TË VENDEVE TË BE

Itali - Neni 519: Mbi dhunën seksuale

Francë - Nenet 227-15 deri në nenin 227-28-1: Vendosja në rrezik e të miturve

Gjermani - Seksioni 176, Abuzimi i Fëmijës

Bullgaria - Neni 149: Marrëdhënie seksuale me të mitur nën 14 vjeç.

VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUETSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN VENDAS DHE NDËRKOMBËTAR

Propozimet vijnë në përputhje të plotë me Kushtetutën e Shqipërisë, e cila përcakton mbrojtjen e posaçme që gëzojnë gratë dhe fëmijët. Po ashtu propozimet ligjore përforcojnë perkufizimet dhe dënimet e disa veprave penale, të cilat sjellin pasoja të rënda mbi jetën, dinjitetin dhe mirëqenien fizike dhe emocionale të viktimave.

Gjithashtu propozimet forcojnë zbatimin e legjislacionit ndërkombëtar sidomos të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF) dhe të Konventës për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), ku Shqipëria është shtet palë. Po ashtu propozimet janë në përputhje të normave dhe standarteve të legjislacionit të Këshillit të Europës: Konventa e të Drejtave të Njeriut dhe posaçërisht Konventa e Lanzarote.

Propozimet janë në përputhje të plotë dhe të harmonizuara me legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar.

VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFËRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Shtesat e propozuara vijnë si pasojë e rekomandimeve dhe kërkesave që kanë dalë nga Direktiva 2011/92/EU e Parlamentit Europian dhe Keshillit Europian te 13 Dhjetorit 2011 mbi luftën kunder abuzimit seksual, shfrytëzimit seksual dhe pornografise se femijeve, qe zevendesoi Vendimin Kornize te Keshillit Europian 004/68/JHA.

Keto shtesa e përfaqërojnë legjislacionin shqiptar me këtë Direktivë dhe e sjellin atë në linjë me kriteret ligjore të *Aquis*.